

**FJALIM NGA ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I SEKRETARIT
TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut
DEBATI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT MBI UNMIK-un**

Nju Jork

7 shkurt 2018

Z. President, shtete anëtare,

Në fillim dëshiroj të uroj të gjitha shtetet e reja anëtare që i janë bashkuar Këshillit të Sigurimit në vitin 2018. Në veçanti dëshiroj tu uroj juve z. President, dhe Kuvajtin për mbajtjen e Presidencës së Këshillit këtë muaj.

Sot unë do t'ju njoftoj për zhvillimet e reja, disa prej të cilave janë të mirë dokumentuara në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm që e keni përpara jush, duke u përqendruar në faktet kryesore që kanë mbizotëruar gjatë periudhës raportuese dhe ditëve në vijim.

Z. President,

Dje u paraqit strategjia e re për zgjerim e Bashkimit Evropian për Ballkanin perëndimor, korniza më ambicioze dhe me ndikim më të gjerë për veprim që nga Samiti i Selanikut në vitin 2003. Strategjia e re e trason rrugën përpara për zgjerim që lidhet me reformat politike dhe socio-ekonomike, si dhe me pajtimin dhe zgjidhjen e qëndrueshme të mosmarrëveshjeve. Në Kosovë pati një reagim të përzier, por shumica e udhëheqësve të Prishtinës e potencuan rëndësinë e kësaj strategjie të re për realizimin e perspektivës evropiane për Kosovën. Brenda kësaj kornize të re, z. President, është e qartë se dialogu dhe normalizimi i marrëdhënieve

në mes të Beogradit dhe Prishtinës janë parakushte për aspiratat e Kosovës për në BE.

Z. President,

Ndonëse ka pas disa kontakte formale dhe joformale të nivelit të lartë të liderëve nga Prishtina dhe Beogradi, ka më shumë se një vit që në nivel teknik, dialogu ka prodhuar pak progres kuptimplotë. Një numër i marrëveshjeve ekzistuese mbeten akoma për t'u implementuar plotësisht; më esencjalja në mesin e tyre Asociacioni /Bashkësia e komunave me shumicë serbe. Viti 2018 mund të paraqesë një momentum të ri për këtë dialog, dhe siç theksoi edhe vet Përfaqësuesja e lartë e BE-së dje, dialogu mund të përmbillet pozitivisht, me vullnet të mjaftueshëm nga liderët dhe me inkurajim adekuat nga bashkësia ndërkombëtare.

Z. President,

Tentimi i fundit për të shfuqizuar ligjin për Dhomat e posaçme nga disa anëtarë të koalicionit qeverisës në Kuvendin e Kosovës, tërhoqi vëmendjen dhe ngriti shqetësime serioze nga të gjitha palët e interesuara për zotimin e Kosovës për drejtësi dhe zbatimin e paanshëm të sundimit të ligjit. Themelimi i Dhomave të posaçme të Kosovës dhe i Prokurorisë speciale, të miratuar nga Kuvendi në vitin 2015, ishte një e arritur e madhe për Kosovën. Në kundërshtim me këtë përparim, në mbrëmjen e 22 dhjetorit, disa deputet të Kosovës nisën përpjekjen për shfuqizimin e një ligji kyç që mbështet punën e Dhomave të posaçme. Pothuajse të gjithë partnerët rajonal dhe ndërkombëtarë të Kosovës e bënë të qartë se një veprim i tillë, nëse do të ishte i suksesshëm, do të ishte thellësisht i dëmshëm për aspiratat e Kosovës dhe reputacionin e saj. Disa nga liderët politikë u tërhoqën nga ky propozim, mirëpo

mocioni për të shfuqizuar ligjin për momentin mbetet në agjendën e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit të Kosovës më garantoj mua se liderët në Prishtinë do të qëndrojnë pranë zotimeve të tyre ndërkombëtare. E shfrytëzoj këtë mundësinë të përsëris: kjo gjykatë nuk ka në shënjestër ndonjë komunitet apo grup të caktuar, por vetëm përgjegjësinë penale të individëve. Kjo është diçka e mirënjohur nga shumica në Kosovë, të cilët e kuptojnë se shfuqizimi i Dhomave të posaçme thjeshtë nuk është opsion. Mënyra e vetme përpara është pranimi i drejtësisë.

Z. President,

Vrasja më 16 janar në pikë të ditës e Oliver Ivanoviçit, politikanit të spikatur serb të Kosovës, tronditi Kosovën dhe rajonin; duke ngritur shqetësime për një të ardhme me një valë tjetër të jostabilitetit politike. Unë e dënova vrasjen disa orë pasi ndodhi, duke bërë thirrje për qetësi si dhe për veprim të shpejtë dhe vendimtarë nga autoritetet hetuese. Të gjithë përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare ishin të bashkuar në këtë pikëpamje. Për më tepër, ju kam bërë thirrje të gjithëve të punojnë së bashku për të siguruar që autorët e këtij akti brutal të sillen para drejtësisë.

Është me rëndësi të theksohet se liderët në Beograd dhe në Prishtinë kanë reaguar ndaj kësaj ngjarje në mënyrë të menjëhershme dhe të përgjegjshme. Meqë Policia e Kosovës e drejton hetimin, Prishtina dhe Beogradi janë pajtuar të ndajnë informacionet dhe të përkrahin procesin. Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç, e vizitoi Kosovën pas këtij incidenti, duke i thënë komunitetit serb të Kosovës në veri dhe në jug të Kosovës se paqja ishte e një rëndësie të madhe. Dua po ashtu të theksoj rolin konstruktiv të zyrtarëve të Prishtinës për mundësimin e kësaj vizite.

Në takimet e mia me liderët në Prishtinë, ata ma bënë të qartë se po bëjnë çdo gjë që është e nevojshme në gjetjen e autorëve të këtij krimi dhe motiveve të vrasjes. Beogradi është duke bashkëpunuar me hetuesinë, por shqetësimet ekzistojnë, duke përfshirë edhe atë për efikasitetin e shkëmbimit të informacioneve. Mossuksesi në identifikimin e autorëve nuk do të ishte vetëm dështim i tmerrshëm i drejtësisë, por do të rrëronte edhe besimin në të gjitha anët.

Z President,

Në vitin 2017 në Kosovë u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe komunale, si dhe u formua qeveria e re. Populli i Kosovës ka pritje të mëdha nga qeveria dhe Kuvendi i tij, duke marrë parasysh nevojat dhe premtimet që i janë dhënë. Realiteti i hidhur i jetës së përditshme në Kosovë përfshin papunësinë, sfidat për qeverisje të mirë, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe korrupsionin dhe krimin e organizuar. Të gjitha këto kërkojnë që akterët politikë të bashkohen, t'i lënë pas dallimet e tyre dhe të arrijnë unitet për të mirën e popullit. Ata do të ndihmohen në këtë drejtim, duke siguruar një marrëdhënie pozitive dhe produktive me bashkësinë ndërkombëtare dhe me të gjitha pranitë institucionale në terren.

Një shembull i mirëpritur në këtë drejtim janë përpjekjet e unifikuara të partive politike për miratimin e Agjendës së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm 2030. Gjithashtu desha të përgëzoj përkushtimet e qeverisë në luftimin e varfërisë, përmirësimin e arsimit dhe edukimit, prioritetizimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e mjedisit, avancimin e shoqërisë së drejtë dhe paqësore, si dhe në sigurimin e prosperitetit për të gjithë – përkushtime këto që janë thelbësore për tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova.

Z. President,

Bashkësia ndërkombëtare vazhdon t'u ndihmojë institucioneve të Kosovës në avancimin e drejtësisë, sundimin e ligjit dhe të drejtave të njeriut. Qeveria e Kosovës ka miratuar katër propozimligje lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës së tij. Po ashtu, dua të theksoj se integrimi i gjyqësorit është duke ecur përpara, ku tani zyrtarët e Gjykatës themelore në Mitrovicë dhe të Zyrës së Prokurorisë janë duke punuar brenda sistemit të unifikuar të drejtësisë në Kosovë. Misioni ynë dhe pranitë e tjera ndërkombëtare janë duke punuar ngushtë me njëra-tjetrën për të mundësuar funksionimin e plotë të këtij sistemi të integruar, duke përcjellë fjala bie çështjet, siç është respektimi i plotë i të drejtave gjuhësore.

Njëkohësisht dëshirojmë të theksojmë vendimin e qeverisë së Kosovës për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale që lidhen me konfliktin, duke përfshirë edhe ndarjen e pensioneve mujore për të mbijetuarat. Po kështu, mirëpres emërimin e zëvendëskryesuesit të Komisionit për persona të zhdukur të qeverisë së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

Përkundër këtyre hapave të rëndësishëm, ende mbetin shumë sfida në avancimin e sundimit të ligjit dhe fuqizimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Udhërrëfyes i punës në këtë fushë duhet të jenë praktikatat më të mira ndërkombëtare. Në kuadër të disa aspekteve negative në sundimin e ligjit, falja nga ana e presidentit e tre individëve të dënuar për vrasje lidhur me rastin e familjes Hajra ka qenë veçanërisht shqetësuese. Mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk duhet të zbehet nga konsideratat

politike apo dimensionet etnike; tentimet e tilla do t'i hidhnin hije të keqe premtimeve për një shoqëri të bazuar në sundimin e ligjit.

Z. President,

UNMIK-u dhe partnerët e tij kanë ndihmuar në fuqizimin e rolit të gruas dhe rinisë, në mënyrë që të konsolidohet kontributi i tyre thelbësor për paqe, siguri dhe për ndërtimin e mirëbesimit mes komuniteteve. Fushata vjetore ndërkombëtare “16 ditë të aktivizmit kundër dhunës gjinore” u realizua në mbarë Kosovën gjatë kësaj periudhe raportuese. Në fushatë u nënvizuan veprimet e bashkësisë ndërkombëtare, të qeverisë dhe të shoqërisë civile, që kontribuan në vetëdijesim lidhur me nxitësit dhe pasojat e dhunës kundër femrave dhe vajzave. Gratë ende ballafaqohen me një sfidë të vështirë në politikat zgjedhore. Nga 204 kandidatë për kryetar komunash në tërë Kosovën, vetëm tetë prej tyre kanë qenë femra. Së këndejmi, kërkohet një përpjekje e bashkërenduar për arritjen e përfaqësimit më të balancuar dhe për krijimin e një hapësire më të baraspeshuar për punën e tyre.

Ngjashëm me këtë, agjenda për rininë, për paqen dhe për sigurinë mbetet e rëndësishme në Kosovë. Rinia e Kosovës, përkundër frustrimeve të kuptueshme me status kuon, janë shpresa për një të tashme dhe të ardhme më të mirë. UNMIK-u vazhdon të angazhohet me të rinjtë e mbarë Kosovës përmes nismave, siç është Asambleja e të Rinjve e Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Unë jam i frymëzuar nga fuqia e karakterit e liderëve të rinj që i kam takuar – liderë këta që kanë kurajën për të shkuar përtej ndarjeve shoqërore dhe për të krijuar strategji e vizion të përbashkët për një shoqëri të suksesshme e shumetnike.

Ndërtimi i besimit mes komuniteteve mbetet thelbësor për Misionin. Paqja e qëndrueshme nuk mund të arrihet pa angazhimin e të gjitha institucioneve dhe ndihmesën e bashkësisë ndërkombëtare në ndërtimin e urave për besim afatgjatë. Misioni ynë ka ndërmarrë një numër iniciativash të fokusuara në përkrahjen e ndërtimit të besimit nga niveli bazë dhe në shfrytëzimin e njohurive të Kombeve të Bashkuara për të ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi. Në të gjitha nivelet e shoqërisë së Kosovës ka shumë liderë që janë të përkushtuar për këtë agjendë dhe që japin përkrahje në mënyrë aktive.

Z President,

Ky moment paraqet mundësi për progres dhe për çuarjen përpara të dialogut politik. Mu para këtij sesi të Këshillit kam pasur një numër konsultimesh me liderët dhe zyrtarët në Prishtinë, Beograd dhe Tiranë. Përkundër dallimeve domethënëse të shprehura, unë jam i bindur se këta liderë gjithashtu kanë kuptueshmëri më të gjerë të natyrës së sfidave që duhet të tejkalohen dhe të moszvarritjes së vazhdueshme të punës së sotme për nesër. Dua të nënvizoi se përkundër të gjitha mospajttimeve, nuk duhet të nënvlerësohet potenciali për besim dhe për vendimmarrje më vizionare.

Ju faleminderit shumë.